



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 27  
Prishtinë, 12 janar 2009, ora 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Bujar Bukoshi.

Mungoi: Gjylnaze Sylja, Slllobodan Petroviq dhe Teuta Hadri.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

*Komisioni i zhvilloi punimet me këtë*

**REND DITE**

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Komisionit,**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

*Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluara pa vërejtje.*

### 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Komisionit

**Sadik Idriz** – Tha se stafi i Komisionit e ka përgatitur një draft të raportit për punën njëvjeçare të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në këtë draft janë paraqitur aktivitetet e Komisionit gjatë vitit 2008. Në raport janë përfshirë ligjet e miratuara, amendamentet në ligje, çështje të tjera të shqyrtuara nga Komisioni, vizitat, takimet dhe aktivitetet rreth monitorimit të zbatimit të ligjeve. U hap diskutimi për plotësimin e draftit me propozime të anëtarëve të Komisionit.

**Nurishahe Hulaj** – Tha se në përgjithësi janë paraqitur disa aktivitete të Komisionit, por drafti duhet të plotësohet dhe të strukturohet. Disa takime të përshkruhen më hollësisht, të paraqiten edhe disa fotografi në raport që ky ta ketë një strukturë tjetër. Patjetër duhet të paraqiten më gjerësisht ngjarjet dhe të përpiqemi që raporti të jetë më gjithëpërfshirës.

**Armend Zemaj** - E falënderoi stafin se i ka përfshirë të gjitha aktivitetet e Komisionit në këtë draft të raportit të punës, por tha se raporti duhet të plotësohet në disa çështje dhe disa aktivitete të Komisionit të përfshihen më gjerësisht.

**Bujar Bukoshi** – E kam vetëm një pyetje, që më intereson të sqarohet. Në media kam dëgjuar se Ministria e Shëndetësisë ka suficit të madh nga viti që shkoi. Nuk e di a është e vërtetë kjo informatë. Nëse është e vërtetë, është mjaft brengosëse, sepse shëndetësia ka aq shumë probleme dhe aq shumë nevojë saqë është e pakuptimtë të ketë suficit. Mendoj se kjo informatë duhet të verifikohet në rrugë zyrtare.

**Sadik Idriz** - Lidhur me pyetjen e dr. Bukoshit mund t'i ftojme përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë ose ministrin që ta diskutojmë këtë çështje.

**Rita Hajzeraj** – Tha se raporti është gjithëpërfshirës. Në të mund të pasqyrohen më hollësisht disa aktivitete të Komisionit.

**Qamile Morina** – Tha se në raportin e punës të Komisionit janë paraqitur të gjitha aktivitetet tona. Për çdo aktivitet dhe vizitë ka raporte të veçanta, në të cilat janë paraqitur hollësisht diskutimet tona. Lidhur me suficitin e Ministrisë së Shëndetësisë, në raportin gjashtëmujor të Qeverisë, thuhet se Ministria e Shëndetësisë ka shpenzuar vetëm 17% të buxhetit. Kjo mund të jetë edhe e vërtetë. Kështu në gjashtëmujorin e dytë nuk ka mundur ta shpenzojë pjesën tjetër të buxhetit. Ministria e Shëndetësisë nuk po e lejon qasjen në dokumente zyrtare. Duhet t'i ftojme përfaqësuesit e Ministrisë të na e japin një pasqyrë rreth këtij suficiti, që paraqitet në media dhe të na informojnë për planet dhe për prioritetet e kësaj ministrie për këtë vit.

**Flora Brovina** – Raporti i punës së Komisionit të plotësohet edhe me disa aktivitete që duhet të paraqiten më hollësisht, sepse ky mbetet dokument në arkiva edhe për të ardhmen. Sa i përket suficitit të Ministrisë së Shëndetësisë duhet të verifikohet informata, sepse mediat në kohën e fundit janë marrë shumë me Qeverinë. Shumë gjëra mund të mos jenë të sakta. Për to duhet të kemi informata të plota. Duhet t'i ftojme të dy ministrat, atë të Shëndetësisë dhe atë të Financave, që të na japin informata më të plota për suficitin e Ministrisë së Shëndetësisë.

**Armend Zemaj** - Tha se sipas informatave nga zyrtarët përgjegjës të MSH-së, suficiti i kësaj ministrie për vitin 2008 është 4 milionë e 400 mijë euro, pra janë shpenzuar 93.5 % të buxhetit. Suficiti është i kategorisë së pagave, mëditjeve dhe i obligimeve të pashlyera.

**Sadik Idriz** – Tha se mund ta ftojme ministrin e Shendetesisë në një mbledhje të Komisionit, në të cilën të diskutojmë për suficitin dhe për çështje të tjera që na interesojnë për shendetësinë. Duhet t'i saktësojmë çështjet për të cilat do të diskutojmë dhe pastaj ta ftojme atë. Mund të diskutojmë për suficitin, kujdestaritë, për Ligjin e sigurimeve shendetësore, për 44 eurot e papaguara dhe për çështje të tjera.

*Kryetari e përfundoi këtë pikë me konstatimin se raporti mund të plotësohet nga anëtarët e Komisionit dhe të bëhet përfundimtar. Gjithashtu tha se mund ta ftojme ministrin e Shendetesisë që të diskutojmë për çështje të caktuara.*

#### **4. Të ndryshme**

**Flora Brovina** - Propozoi që në Komision të diskutojmë dhe të ftohet ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale.

**Sadik Idriz** – Tha se ka shumë parregullsi në atë ministri. Mendon se duhet të ftohet patjetër ministri dhe të diskutohet rreth punës së kësaj ministrie.

**Armend Zemaj** – Propozoi të ftohet ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe të diskutohet për zbatimin e Ligjit për skemën sociale.

**Rita Hajzeraj** - Gjithashtu propozoi që gjatë këtij viti të monitorohet Ligji për skemën sociale.

**Qamile Morina** – Propozoi që gjatë këtij viti të monitorohen dy ligje: njëri i fushës së punës dhe i mirëqenies sociale, tjetri i shendetësisë.

**Sadik Idriz** – Në të ndryshme të diskutohet për dëgjimin publik dhe kur do ta mbahet. E kemi edhe një propozimistë nga stafi se kë duhet ta ftojme dhe çka mund të plotësojmë.

Dëgjimin ndoshta mund ta mbajmë pas dy javësh. Të ftohen më shumë shoqata të mjekëve që merren me veprimtari private.

Deri në javën e ardhshme do t'i përfundojmë: përgatitjen, plotësimin e listës se kë do ta ftojme dhe do t'i përgatitim ftesat. Qamilja ta përgatitë një hyrje për qëllimin e mbajtjes së dëgjimit publik.

Të sigurohet edhe lista e institucioneve të licencuara dhe të palicencuara.

Gjithashtu u tha se plani i punës do të përgatitet pasi të na vijë strategjia legjislative nga Qeveria e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15 min.

*E përgatiti:*

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

---

*Sadik Idriz*